



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi

ndërmjet

**Organit Kombëtar të Investigimeve
të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore
në Aviacionin Civil**

dhe

Aeroportit Ndërkombëtar Nënë Tereza

**Lidhur me Bashkëpunimin dhe Mirëkuptimin në rastet e
Aksidenteve dhe Incidenteve në fushën e Aviacionit Civil**

PËRMBAJTJA

1. Fjalori
2. Hyrje
3. Terminologja
4. Qëllimi
5. Mirëkuptim i ndërsjelltë dhe bashkëpunimi në rast aksidenti/incidenti
6. Bashkëpunimi në fushën teorike për ngritjen e nivelit të sigurisë
7. Rolet dhe detyrat e palëve
8. Parimet bazë të MB
9. Kontaktet

1. FJALORI (shpjeguesi i termave të përdurura)

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
AC	Aviacioni Civil
TIA	Tirana International Airport
MB	Memorandum Bashkëpunimi
RSh	Republika e Shqipërisë
OKIIA	Organi Kombëtar i Investigimeve të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil
CVR	Cockpit Voice Recorder
FDR	Flight Data Recording
A/C	Aircraft (avion)
ODM	Operation Duty Manager
LCC	Load Control Center
DC	Departure Control System
G/Ops	Ground Operation
F/Ops	Flight Operation
VQA	Vend Qëndrim i A/C(Apron)
Rwy	Pista e ngritjeve dhe uljeve të A/C
Txw	Rruga e A/C për dhe nga Pista

2. HYRJE

2.1. Ky Mermorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi shpreh mirëkuptimin e OKIIA dhe TIA, të cilave më pas do ti referohemi si Palë në këtë MB, lidhur me bashkëpunimin dhe asistencën në rastin e një Aksidenti/Incidenti të rëndë në fushën e AC.

Dihet se të dy Palët i përgjigjen ligjeve të RSh-së dhe për këtë arsyet ata janë të lidhur nga standartet e përfshira në këtë legjislacion:

- a) Ligji Nr.10040, datë 22.12.2008. Per "Kodin Ajror" te RSh i ndryshuar
- b) Ligji Nr.10233, datë 11.02.2010. Per "Aviacionin Civil" i ndryshuar
- c) Ligji Nr. 9312, date 11.11.2004 Ligji i Koncessioneve midis TIA shpk dhe RSh
- d) Vendimi i Këshillit te Ministrave Nr.686, datë 2.6.2010. Per krijimin e Organit Kombtar te Investigimit te Aksidenteve/Incidenteve Ajrore ne Aviacionin Civil

2.2. Ky MB përcakton masat proceduriale për bashkëpunim dhe asistencë midis Palëve në përputhje me legjislacionin e mesiperm.

3. TERMINOLOGJIA

3.1. Fjalët dhe frazat e përdorura në këtë dokument, kanë të njëjtin kuptim ashtu si përshkruhet në legjislacionin e RSh.

4. QËLLIMI

- 4.1.** Memorandumi i Bashkëpunimit (më poshtë do të shkruhet MB) ka si qëllim që nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, kordinimit të veprimeve në vendin (Aerodrom) e ndodhjes se ngjarjes, dhënien e dokumentave relevante që TIA disponon per avionin dhe fluturimin e A/C te aksidentuar ose me incident të rëndë, mbështetjen e palëve me specialistë dhe expertë, për të kryer një investigim sa më objektiv në nxjerrjen e shkaqeve të aksidentit/incidentit të ndodhur.
- 4.2.** Nëpërmjet këtij MB synohet të ndihmohet OKIIA për kryerjen e një Investigimi të saktë e të shpejtë në nxjerrjen e shkaqeve të aksidentit/incidentit, me qëllim parandalimin e tyre në të ardhmen.

5. MIRËKUPTIMI DHE BASHKËPUNIMI I NDËRSJELLTË

MB angazhon TIA në informimin sa më të shpejtë nëpërmjet ODM në rasin e ndodhjes se një aksidenti/incidenti në rajonin e Aerodromit (në ulje, ngritje dhe lëvizje në tokë të A/C).

- 5.1.** Palët punojne se bashku në përgatitjen dhe zbatimin e rekomandimeve të cilat u jepen operatorëve për parandalimin e aksidenteve/ incidenteve në të ardhmen.
- 5.2.** MB synon rritjen e efikasitetit në kryerjen e detyrës e të dy Palëve, në rast të një aksidenti/incidenti të rëndë:

- a) Përmirësimin e sigurisë së lëvizjeve së A/C në territorin e Aeroportit (taxiway runway dhe apron)
- b) Përmirësimin e Navigimit për uljen dhe ngritjen e A/C.
- c) Përmirësimin e masave në raste Emergjencash si: ulje e detyruar brenda dhe jashtë Arodromit.

- d) Përsosjen e masave të evakuimit te pasagjerëve dhe transportimin e tyre në rast të zjarrit në A/C dhe VQA.
- 5.3. Nëpërmjet këtij MB, TIA siguron përfaquesit e OKIIA (IND) lëvizjen me mjete nëpër territorin e Aeroportit me kordinimin paraprak me TIA-n ne rast incidentesh/aksidentesh.
- 5.4. Në lidhje me zhvendosjen e avionëve të aksidentuar, për të mos penguar uljen, TIA aplikon praktikat dhe standartet ndërkombëtare, dhe respekton AOM (Manualin e Aerodromit) që është në fuqi, duke marre parasysh dhe kërkesat e IND për ruajtjen e tyre në vend të sigurtë.
- 5.5. TIA dhe OKIIA përcaktojnë së bashku vendin dhe mënyrën e ruajtjes se pjesëve të A/C të aksidentuar.
- 5.6. TIA në rast të aksidentit/incidentit siguron për IND dokumente si më poshtë:
- a) Listën e plotë të pasagjerëve në ngritje ose ardhje nëpërmjet ODM.
 - b) Fletën e Loadsheets të A/C që po ngrihej / ulej nga LCC.
 - c) Fletën e shërbimeve të kryera nga G/Ops ose G/Service të Aeroportit
- 5.7. TIA siguron pjesëmarrjen e përfaqësuesit të OKIIA në Sallën e Emergjencave.
- 5.8. IND kryen investigimin në mënyrë të pavarur në fushën teknike dhe pjesemarrja e tij në investigim nuk ka për qëllim përcaktimin e besueshmërisë apo të fajit.
- 5.9. OKIIA dhe TIA pranojnë se ky MB nuk kufizon diskrecionin dhe kompetencat e secilës palë bazuar në legjislacion.

6. BASHKËPUNIMI NË FUSHËN TEORIKE PËR RRITJEN E NIVELIT TË SIGURISË

- 6.1. Secila palë pranon rolin e rëndësishëm të palës tjetër në lidhje me interesin publik dhe nevojën e kryerjes së detyrës sa më mirë dhe brenda një kohe sa më te shkurter, bazuar ne detyrimet e tyre ligjore.
- 6.2. Palët sigurojnë pjesëmarrje në seminare, analiza dhe mesime treguese te organzuara prej Paleve, kryesish prej TIA, lidhur me problemet e Sigurisë së Operimeve Fluturuese në Aeroport.
- 6.3. Palët marrin përsipër të organizojnë takime e konsultime për probleme të vecanta në rang specialistësh dhe expertësh.
- 6.4. TIA merr përsipër pjesëmarrjen e përhershme të përfaqësuesit të OKIIA në sallën e Emergjencave.

7. ROLET DHE DETYRAT E PËRBASHKËTA

- 7.1. TIA duhet të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur OKIIA për çdo rast incidenti/aksidenti të një A/C në zonën e aerodromit.
- 7.2. TIA i jep IND të OKIIA të dhëna për identifikimin e zonës së ndodhjes së ngjarjes, të dhëna të operatorit: tipi i avionit, numri i fluturimit, shenja e thirrjes, origjina dhe destinacioni i fluturimit.

8. PARIMET BAZË TË MB

- 8.1. Palët sigurojnë që punonjësit përkatës të tyre të familiarizohen me përbajtjen dhe kërkesat e MB.
- 8.2. Ky MB hyn në fuqi menjëherë në datën që nënshkruhet nga të dy palët, dhe vlefshmëria e tij do te zgjase deri ne momentin kur njera nga palet kerkon ose te dyja palet bien dakort t'i jasin fund vlefshmerise se tij.
- 8.3. Palët mund t'a ndryshojnë këtë MB në çdo moment duke rënë dakort midis tyre. Çdo ndryshim duhet të bëhet me shkrim dhe do të integrohet në formën e një shtojce të këtij MB. Ndryshimet hyjnë në fuqi në datën që bihet dakort në shtojcë perkatese.
- 8.4. Palët mund të shprehin lirisht dëshirën për mbarimin e afatit të MB në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim palën tjetër.
- 8.5. Ky memorandum mbahet në 6 (gjashtë) kopje, nga 3 (tre) për secilën palë.

9. Kontaktet për zbatimin e MB

	OKIIA	TIA
<i>Adresa:</i>	Rruga Pashko Vasa, P.13/6 Tiranë, P.O.Box74	Aeroporti Nderkombetar "Nënë Tereza" Tiranë
<i>Tel:</i>	+355 47 203686	+355 4 2381600
<i>Fax:</i>	+355 47 203685	+355 4 2231545
<i>Mobile:</i> (24/7)	+355 67 20 12 000 +355 68 20 21 409	+355 692022005 (ODM)
<i>E-mail:</i>	info@okiiia.gov.al	odm@tirana-airport.com

TIRANE 26.07.2016

Drejtor i Përgjithshëm OKIIA

Dipl.Ing. Arben XHIKU



Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv TIA

Rolf Castro-Vasquez

